



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR

VENDIM

Nr. 18, Datë 17.12.2024

“Për miratimin e strukturës së Dokumentit Analistik, përbërjen e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë (GENL), Sekretariatit Teknik (ST) dhe Ekspertizës ndërkombëtare, për hartimin e analizës dhe PKV për komponentin III.3 ‘Konsolidimi i Sistemit të Drejtësisë’.”

Bazuar në nenet 24 dhe 32 - 41 të Rregullores së Kuvendit, në zbatim të Rezolutës së Kuvendit të datës 27.5.2024 dhe në mbështetje të Vendimit Nr. 50/2024, datë 30.05.2024 të Kuvendit të Shqipërisë “Për ngritjen e Komisionit të Posaçëm për Thellimin e Reformave për Mirëqeverisjen, Sundimin e ligjit dhe Antikorrupsionin për Shqipërinë 2030 në Bashkimin Evropian”, me propozim të Kryetarit, Komisioni i Posaçëm Parlamentar

VENDOSI:

1. Të miratojë procesverbalin e zbardhur të mbledhjes paraardhëse, të zhvilluar më datë 28.10.2024.
2. Të miratojë në parim strukturën e Dokumentit Analistik/analizës lidhur me Komponentin 3, 'Konsolidimi i Sistemit të Drejtësisë', pjesë përbërëse e Shtyllës III – Sundimi i Ligjit, sipas Aneksit 1 bashkëlidhur këtij vendimi".
3. Të miratojë përbërjen e Grupit të Ekspertëve të Nivelit të Lartë, Sekretariatit Teknik, si dhe Ekspertizës Ndërkombëtare, të cilët do të angazhohen dhe kontribuojnë në procesin e punës për hartimin e Dokumentit Analistik dhe Planit të Veprimit në kuadër të Shtyllës III “Sundimi i Ligjit” – Komponenti 3 “Konsolidimi i Sistemit të Drejtësisë”, sipas Aneksit 2 bashkëlidhur këtij vendimi."
4. Të miratojë në parim dokumentet bazë orientuese, mbi të cilat do të mbështetet procesi i punës për analizën e Komponentit III.3 “Konsolidimi i Reformës në Drejtësi”, sipas Aneksit 3 bashkëlidhur këtij vendimi."
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

FATMIR XHAFAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

KOMISIONI I POSAÇËM PARLAMENTAR PËR THELLIMIN E REFORMAVE PËR
MIRËQEVERISJEN, SUNDIMIN E LIGJIT DHE ANTIKORRUPSIONIN PËR
SHQIPËRINË 2030 NË BASHKIMIN EUROPIAN

Dokument pune i Komisionit

Draft

DOKUMENTI ANALITIK
Hartuar nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të Lartë

Aneks 1

Shtylla III/3
3.Konsolidimi i Reformës në Drejtësi

3.1. NJË VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM

1. Kuadri kushtetues dhe ligjor i reformës në drejtësi, dokumentet strategjike, organet e specializuara, institucionet e menaxhimit të sistemit të drejtësisë;

2. Procesi i zbatimit të reformës në drejtësi. Arritjet dhe hapat pozitivë në këtë fushë (bazuar kryesisht në vlerësimet e bëra nga raportet ndërkombëtare dhe ato lokale si dhe në Raportet e vet Institucioneve në Kuvend për vitet 2022/2023 dhe Rezolutat e miratuara për vitet 2023/2024);

(Domosdoshmëria e marrjes së masave për të konsoliduar më tej reformën në drejtësi, dhe thellimin e zbatimit të kuadrit të reformave ligjore dhe institucionale duke garantuar bashkëpunimin efektiv ndërmjet institucioneve të drejtësisë, alokimit të burimeve të mjaftueshme dhe funksionimin sistemik eficent të sektorit të drejtësisë).

3. Gjetjet dhe rekomandimet kryesore për adresim në këtë fushë (Burimi kryesor: Raportet ndërkombëtare dhe kryesisht Raporti Screening i KE dhe Progres Raportet për Shqipërinë në vitet 2023/2024 si dhe Raporti për Shtetin e së Drejtës 2024: Kapitulli për Shqipërinë – Korrik’24, Strategjia Ndërsektoriale e sistemit të drejtësisë – përfshi Planin e Veprimit dhe Pasaportën e treguesve, Raportet e vet Institucioneve të pavarura në Kuvend për vitet 2022/2023 dhe Rezolutat e miratuara për vitet 2023/2024 duke përfshirë dhe dokumentat e prezantuara prej vet institucioneve të drejtësisë me propozime për ndërhyrje ligjore në kuadrin ligjor ekzistues të sistemit etj).

3.2. PAVARËSIA DHE PAANËSIA E SISTEMIT TË DREJTËSISË

- Mbrojtja dhe konsolidimi i pavarësisë së magjistratëve dhe institucioneve të drejtësisë;
- Parandalimi dhe ndëshkimi i çdo lloj ndikimi të brendshëm e të jashtëm si dhe presioni dhe shantazhi politik ndaj magjistratëve dhe vet sistemit;
- Parandalimi i konfliktit të interesit dhe dukurive të koorporativit e nepotizmit në sistem;
- Procedurat e emërimeve, transferimeve dhe promovimit bazuar në meritë të magjistratëve dhe në procedura transparente.

3.3. LLOGARIDHËNIA. Konsolidimi i llogaridhënies dhe integritetit në drejtësi.

- Garantimi i zbatimit të kuadrit ligjor për të demonstruar një track rekord të konsoliduar për llogaridhënien dhe integritetin e sistemit të drejtësisë në të gjitha nivelet
- Përmbyllja e vetingut. Zbatimi dhe respektimi i vendimeve të komisioneve të vettingut.
- Garantimi i trashëgimisë së standardeve të tij dhe zbatimi i masave ligjore për procesin e verifikimit periodik të magjistratëve në detyrë.
- Reagimi ligjor penal ndaj magjistratëve të përjashtuar nga sistemi për elementë kriminal korruptiv;
- Procedurat e procesit të rivlerësimit, sistemi i verifikimit të integritetit periodik të magjistratëve duhet të realizohet dhe të lidhet me sistemin e promovimit të magjistratëve, me të njëjtat standarde të procesit të vettingut.
- Integriteti i magjistratëve dhe forcimi i mekanizmave përkatës për të garantuar deklarimin dhe verifikimin periodik të aseteve të të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve në sistem;
- Forcimi i mekanizmave për përgjegjësinë disiplinore të magjistratëve.
- Garantimi më mirë i pavarësisë, paanësisë dhe profesionalizmit lidhur me rregullat e përbërjes dhe eksperiencës të ILD, më qëllim mbrojtjen nga të gjitha influencat;
- Burimet njerëzore ekzistuese të ILD-së dhe problematikat përkatëse për reflektim;
- Hetimi administrativ i sinjalizuesve dhe shqyrtimi i rasteve të korruptionit brenda sistemit.
- Garantimi i vlerësimit periodik të magjistratëve, të gjyqtarëve dhe prokurorëve nga KLGJ dhe veçanërisht nga KLP.

3.4. CILËSIA E PROFESIONALIZMI

- Cilësia në hetim e gjykim e reflektuar në kuptueshmërinë e qartësinë e vendimeve – aktet gjyqësore;
- Roli i stafit mbështetës në rritjen e cilësisë dhe efikasitetit. Cilësitet e përzgjedhjes dhe menaxhimi i tyre eficent dhe garantimi i burimeve të nevojshme njerëzore dhe financiare për funksionimin e sistemit të drejtësisë;
- Procesi i rregullt ligjor. Barazia e palëve në proces;
- Konsistenza dhe përmirësimi i unifikimit të praktikës gjyqësore nga GjL;

- Vlerësimi i magjistratëve, hetuesve dhe OPGJ-ve. Efektshmëria e procedurave dhe mekanizmave përkatës. Standartet e unifikuara dhe bashkëpunimi institucional;
- Prurjet dhe trajnimi i magjistratëve, hetuesve, OPGJ-ve, këshilltarëve dhe ndihmësve;
- Problematikat në trajnimin fillestare e vazhdues, kapacitetet, cilësia dhe integriteti i stafit pedagogjik dhe Këshillit;
- Rishikimi i provimit të hyrjes së kandidatëve për magjistrat në Shkollën e magjistraturës për të orientuar në rritjen e cilësisë së kandidatëve.
- Buxheti i Shkollës së Magjistraturës.

3.5. EFIÇENCA. AKSESI NË SHËRBIMET E SISTEMIT TË DREJTËSISË

- Forcimi në mënyrë sinjifikative i eficencës së sistemit të drejtësisë duke adresuar kohëzgjatjen e proceseve gjyqësore, numrin e lartë të backlogut nëpërmjet një qasjeje strategjike.
- Adresimi i backlogut (numrit të lartë të çështjeve të pazgjidhura) i krijuar në të gjitha nivelet e gjykatave vecanërisht në nivelin e apelit por edhe në shkallët e para – krasimi me standartet e CEPEJ dhe mbështetja me burime e Planit të veprimit përkatës;
- Zbatimi i hartës së re gjyqësore dhe menaxhimi i problematikave të krijuara vecanërisht në vakancat e sistemit të drejtësisë;
- Aksesi i qytetarëve në sistemin gjyqësor si dhe cilësia e shërbimeve gjyqësore dhe prokurorisë ndaj qytetarëve;
- Mbledhja e të dhënave bazuar në metodologjinë CEPEJ dhe treguesit e efikasitetit sipas standardeve të vendeve të BE-së;
- Ngritja e sistemit të integruar të menaxhimit të çështjeve, ndërlidhja e sigurt me bazat e tjera të të dhënave dhe sistemeve që do krijohen, shpërndarja më mirë e çështjeve tek gjyqtarët dhe prokurorët etj;
- Performanca në drejtimin e prokurorive e gjykatave dhe problematikat përkatëse, duke përfshirë burimet njerëzore ndihmëse për të ulur ngarkesën, burimet financiare etj;
- Vlerësimi dhe promovimi i magjistratëve duhet të forcohet edhe nëpërmjet rregullave të qarta përsa i përket eficencës së magjistratëve, një balancë më e mirë midis kriterieve cilësore dhe atyre sasiore dhe rritja e transparencës së procesit.
- Digitalizimi i shërbimeve gjyqësore ndaj qytetarëve dhe avokatëve;
- Ndihma juridike falas;
- Ndërmjetësimi.

3.6. MIRËQEVERISJA DHE TRANSPARENCA

- Organizimi, transparenca dhe efikasiteti i organeve të pavarura të vetëqeverisjes;
- Marrjen e masave nga ILD për të përafruar plotësisht procedurat e saj me rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe përmirësimi i mëtejshëm i transparencës;
- Procesi për zgjedhjen e anëtarëve jo magjistratë të KLGJ dhe KLP dhe problematikat përkatëse. Roli i tyre në vendimmarrjen e Këshillave; Garantimi dhe forcimi i parimeve të integritetit, pavarësisë dhe konkurueshmërisë dhe transparencës për emërimin e anëtarëve të KLGJ-së dhe KLP-së, vecanërisht për ata jashtë sistemit

- Parandalimi i dukurive të koorporatizmit, ndikimeve klienteliste, lobimeve të brendshshme dhe të jashtme në veprimtarinë e organeve të qeverisjes;
- Zbatimi i planeve për një komunikim efektiv me publikun, me OShC dhe grupet e interesit. Përmirësimi i rregullave të marrëdhënieve të Këshillave me median;
- Zbatimi i teknologjisë në sistemin e drejtësisë në funksion të mirëmenaxhimit, transparencës, aksesit, përmirësimit të shërbimeve etj;
- Kapacitetet e sistemit në buxhet, burime njerëzore, infrastrukturë dhe logistikë, nevoja për një masterplan afatshkurtër dhe afatmesëm në këtë fushë;
- Koordinimi ndërinstitucional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë;
- Bashkëpunimi institucional me dy pushtetet e tjera (legjislativ dhe ekzekutiv) për aspekte të procesit të integrimit të vendit dhe çështje me interes kombëtar duke respektuar parimin e ndarjes dhe balancimit ndërmjet pushteteve.

PËRFUNDIME – GJETJE, VLERËSIME DHE REKOMANDIME PËR SHTYLLËN
III.SUNDIMI I LIGJIT – Komponenti 3 : Konsolidimi i Reformës në Drejtësi.

(Çështje kyçë për debat publik, trajtim e zgjidhje me Planin Kombëtar të Veprimit).

Aneks 2

**Përbërja e Grupit të Ekspertëve të GENL që do të angazhohet
në Shtyllën III "Sundimi i Ligjit" – Komponenti 3 "Konsolidimi i reformës në drejtësi"
për hartimin e Dokumentit Analistik / Analizës dhe Planin e Vepritit.**

1. Grupi i punës i GENL**1.1. Pedagogë të Fakulteteve të drejtësisë**

1. Prof.Dr.Aurela Anastasi – Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
2. Prof. Asoc. Dr. Enkeleda Olldashi – Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
3. Prof. Asoc. Dr. Skerdian Kurti – Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
4. Prof. Asoc. Dr. Nadia Rusi – Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës
5. Prof.As.Dr. Juelda Lamçe – Fakulteti i i Shkencave Juridike, UET
6. Prof. Asoc. Dr. Migena Leskoviku – Universiteti i Tiranës;
- 7.

1.2. Ekspertë të Shoqërisë civile

1. Prof.Nada Dollani – Qendra ALTRI, Pedagoge në Fakultetin e Drejtësisë, UT
2. Gledis Gjipali – Lëvizja Europiane në Shqipëri (EMA)
3. Gerti Shella – Qendra Për Çështjet e Informimit Publik (INFOCIP)
4. Mirsada Hallunaj – Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes (CSDG)
5. Eda Noçka – Qendra ALTRI
- 6.

1.3. Përfaqësues/Ekspertë nga Institucionet e pavarura

1. Arbër Basholli – Inspektorati i Lartë / ILDKPKI
2. Olta Aliaj – Avokati i Popullit
3. Alket Jaupi – Avokati i Popullit
4. Elona Hoxhaj – Komisioneri për DIMDHP
5. ..

1.4. Përfaqësues/Ekspertë nga Organizatat e Komunitetit të Biznesit

1. Av,Florjan Hasko – Biznesi – ICC/International Chamber of Commerce
2. Av.Oltjon Dano – ICC / Studio ligjore "Kalo & Associates"
3. Ardit Seknaj – ICC
4. Shoqata e Bankave .
5. ..

II. Institucionet e drejtësisë do të jenë të pranishme dhe kontribojnë në këtë proces me:

1. Përfaqësues/ekspertë të propozuar nga vet Institucionet e sistemit të drejtësisë

a. Me eksperitizën e popozuar prej tyre

- KLP
- SHM
- DHKA

b. Me përfaqësuesit e caktuar si pikë kontakti dhe me dokumenta

- KLGj
- GjL
- ILD
- PP

2. Bashkëpunim me dokumenta, analiza etj etj

- KPA
- Prokuroria e Posacme
- BKH

III. Do të ftohen si Institucione të atashuara pranë GENL për të kontribuar me dokumenta, analiza etj

- Ministria e Drejtësisë
- Ministri i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin
- Ministri i Shtetit për Integrimin dhe Kryenegociatore
- Ministri i Shtetit për Antikorrupsionin dhe Administratën Publike
- Ministri i Shtetit për Pushtetin vendor
- Avokati i Shtetit
- ..

IV. Sekretariati Teknik

- Moza Arbri, Drejtore Shërbimit Juridik - Kuvendi i Shqipërisë
- Alkida Llakaj, Drejtore e Drejtorisë së Shërbimit të Monitorimeve - Kuvendi i Shqipërisë
- Ejana Xhixha, Drejtoria e Monitorimit – Kuvendi i Shqipërisë
- Flavia Balaj, Këshilltare ligjore - Kuvendi i Shqipërisë
- Xhilda Pinci, Këshilltare ligjore - Kuvendi i Shqipërisë
- Antonela Veshi, Këshilltare ligjore - Kuvendi i Shqipërisë
- Elona Lipivani, Këshilltare ligjore - Kuvendi i Shqipërisë
- Aurela Bicja, Këshilltare ligjore - Kuvendi i Shqipërisë
- Nevin Leka, Këshilltare ligjore - Kuvendi i Shqipërisë
- Ermal Jahaj, Këshilltar ligjor - Kuvendi i Shqipërisë
- Ina Veleshnja – FDUT – Pedagoge, Departamenti i së drejtës penale
- Monika Cano – FDUT – Pedagoge, Departamenti i së drejtës publike
- Alket Jaupi - Avokati i Popullit – Ndihmës Komisioner
- Nadia Guni - Shoqëri Civile - Qendra për Nisma Ligjore Qytetare

dhe

- Elsonida Rama – Ministria e Drejtësisë - Drejtor i Përgjithshëm i Kodifikimit
- Aulona Hazbiu – MSHQV / Eksperte e sundimit të ligjit
- ..

V. Ekspertiza ndërkombëtarë

3.1. Asistenca teknike e misioneve ndërkombëtare

- **Agnes Bernhard** – Delegacioni i Bashkimit Europiane në Tiranë
- **Mary Kate Butterfield** – Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës (Opdat)
- **Isabelle Thomas** – Delic, Ekspertja e propozuar nga Ambasada Franceze
- **BB**
- **OSBE**
- .

3.2. Konsulentë të jashtëm ndërkombëtar

- **Dr. Kristian Turkalj** - Asistent Profesor në Universitetin Kroat Katolik / ish- ekspert ndërkombëtar i lartë në vendet e Ballkanit Perëndimor kryesisht, Kroaci
Fusha e ekspertizës: sundimi i ligjit / procesi i integrimit europian / administratë publike
Ka shprehur preferencë për të treja fushat. 27 Vite eksperiencë
- **As. Prof. Dr. Cristina Poncibò** - Pedagoge e të Drejtës Private Krahasuese, Universiteti i Torinos- Itali
Fusha e ekspertizës: sundimi i ligjit / e drejta europiane / digitalizimi / IA / qeverisja e të dhënave
Ka shprehur interes për fushën “Sundimi i ligjit”, 26 vite eksperiencë
- **Prof. Luigi Melica**- Pedagog dhe Drejtor i Departamentit të Shkencave Juridike, Universiteti i Salentos- Itali
Fusha e ekspertizës: çështjet e integrimit europian / migrimi / politikat ndërkombëtare / të drejtat e fëmijëve.
Nuk ka shprehur preferencë për ndonjërin nga fushat. 28 vite eksperiencë
- **Z. James A. Lofton** - Avokat, Ndihmës profesor në Universitetin “Washington and Lee” SHBA - Fusha e ekspertizës: sundimi i ligjit / antikorrupsioni / çështjet e mjedisit
Ka shprehur preferencë për fushën “Sundimi i ligjit”. 42 vite eksperiencë

Për konfirmim

- **Z. Georg Stawa**, Këshilltar (Sundimi i Ligjit) për Evropën Juglindore, Ministria Federale e Drejtësisë Austriake, / Ish-President i CEPEJ
Fusha e ekspertizës: Sundimi i ligjit / marrëdhënie ndërkombëtare; 25 vite eksperiencë

3.3.Konsulentë të jashtëm shtetas shqiptarë jashtë vendit

- **Znj. Edit Shkreli** – Gjyqtare e Gjykatës Civile, Neë York, SHBA
Fusha e ekspertizës: çështje civile, kryesisht për çështje tregtare, divorce
Nuk ka shprehur preferencë për ndonjérën nga fushat. 12 vite eksperiencë
- **Dr.Klodian Rado** - Avokat/ Ekspert juridik ndërkombetar / Pedagog në “York University”, Toronto / ish- magistrat , Kanada
Fusha e ekspertizës: E Drejta Publike Ndërkombebare/ emigracioni / E Drejta Kushtetuese
Nuk ka shprehur një preferencë për ndonjë nga tre fushat. 20 vite eksperiencë
- **Dr.Gentian Jahjolli** - Këshilltar juridik i komanduar pranë Gjykatës Europiane të Drejtave Civile, Strasburg, France
Fusha e ekspertizës: Drejtësia / Antikorrrupsioni / Të drejtat e njeriut /
Nuk ka shprehur një preferencë për ndonjë nga tre fushat. 15 vite eksperiencë
- **Dr. Ermal Frashëri** - Kerkues shkencor në Qendrën për Zhvillim Ndërkombetar në “Harvard Kennedy School”, Pedagog “Sturm College of La”, Denver, Kolorado, Kanada
Fusha e ekspertizës: antikorrrupsion / e drejta ndërkombebare / zhvillimi ekonomik / migrimi
Ka shprehur interes për fushën e “Sundimi i ligjit”. 20 vite eksperiencë
- **Prof.Ersi Bozheku** – Avokat dhe Pedagog Universiteti eCampus (dega e Romës) & Universiteti “Sapienza” Itali dhe Avokat
Fusha e ekspertizës: korrrupsion / taksa / krime ekonomike / e drejtë penal. Ka shprehur interes për fushat “Sundimi i ligjit”. 17 vite eksperiencë
- **Znj.Arnisa Tepelija**, Doktoraturë në vazhdim në të Drejtën Kushtetuese Krahasuese, Universiteti i Evropës Qendrore, Vjenë, Austri
Fusha e ekspertizës: Drejtësia / Antikorrrupsioni / E drejta europiane /
Nuk ka shprehur preferencë për ndonjérën nga fushat. 8 vite eksperiencë
- **Znj.Sabire Lici**- Presidente dhe drejtuese ekzekutive ‘AETOS Consulting SAS’, studio ligjore për AI / Kërkuese akademike në Laboratorin Akademik të Universitetit të Montpellier për IA, France.
Fusha e ekspertizës: Inteligjenca Artificiale / E drejta kontraktore / E drejta e punës
Nuk ka shprehur një preferencë për ndonjë nga tre fushat. 7 vite eksperiencë.

Aneks 3

Dokumentat bazë orientuese ku do të mbështetet procesi për analizën e komponentit III.3. “Konsolidimi i reformës në drejtësi” për identifikimin e vlerësimeve, gjetjeve, problematikave dhe rekomandimeve për reflektim;

- Progres raportet e BE-së 2022 - 2023 – 2024 (që pritet)
- Raporti Screening cluster 1 “themeloret” i Komisionit Evropian
- Raporti për Sundimin e ligjit të KE 2024/ kapitulli për Shqipërinë,
- Pozicioni negociaues “Themeloret” i Shqipërisë (sapo të bëhet publik)
- Qëndrimi i përbashkët i Bashkimit Evropian – Konferenca për anëtarësimin;
- Udhërrëfyesi për Shtetin e së drejtës;
- Udhërrëfyesi për Reformën në Administratën Publike
- Udhërrëfyesi për Funksionimin e Institucioneve Demokratike etj
- Strategjia ndërsektoriale për sistemin e drejtësisë 2024 - 2030;
- Strategjia antikorrupsion / Drafti në proces
- Raportet e DASH 2023 dhe 2024
- Raportet e paraqitura në Kuvend nga Institucionet e drejtësisë për vitet 2022 – 2024 si dhe Raportet e monitorimit, Procesverbalet e Komisionit të Ligjeve dhe Seancës Plenare dhe Rezolutat e miratuara nga Kuvendi;
- Rekomandime që janë referuar nga Këshilli Kombëtar i Integrimit europian në fushën e drejtësisë;
- Raportet e GRECOS, Raundi i IV, dhe Raundi i V i pritshëm;
- Raportet e organizatave ndërkombëtare me fokus reformën në drejtësi, si Këshilli i Europës (post monitoring evaluation report për Shqipërinë), OECD, etj
- Raportet e organizatave vendase që kanë monitoruar sistemin e drejtësisë;
- Të dhënat e CEPEJ për efektshmërinë e sistemit të drejtësisë;
- Analiza dhe artikuj studimor nga media investigative për sistemin e drejtësisë;
- Sondazhe të ndryshme të kryera nga media dhe organizata të ndryshme lidhur me zbatimin e reformës në drejtësi;
- Dokumenta të Reformës në Drejtësi. 2014 - 2016. (Analiza, Strategjia, Plani i Veprimit etj)
- .